



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Plani dhe programi punës për vitin 2016

Prishtinë, 07.03.2016

Kryetari i Komisionit,
Naser Osmani

I. Hyrje

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikës së punës së Komisioneve Parlamentare, Komisioni për Buxhet dhe Financa (tutje Komisioni) ka hartuar planin dhe programin e punës për vitin 2016. Plani përfshinë objektivat, rregullat për funksionimin e brendshëm, fushëveprimin, aktivitetet dhe detyrat të paraqitura në forme tabelare, për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Aktivitetet kryesore të Komisionit gjatë vitit 2016 do të jenë: shqyrtimi/hartimi dhe amendamenti i projektligjeve, shqyrtimi i projektligjit të buxhetit vjetor dhe dokumenteve tjera të ndërlidhura me buxhetin, shqyrtimi i raporteve vjetore dhe financiare të shpenzimeve, organizimi i dëgjimeve publike dhe seancave dëgjimore, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve përkatëse, monitorimi i zbatimit të buxhetit (zbatimit të planit të të hyrave dhe shpenzimeve, dhe respektimi i rregullës fiskale). Plani i punës së Komisionit mund të ndryshohet dhe plotësohet, sipas nevojës dhe aktiviteteve të Komisionit.

II. Anëtarët e Komisionit

Komisioni përbëhet prej 11 anëtarëve, që përfaqësojnë grupet e ndryshme parlamentare në komision. Anëtarët e komisionit janë si në vijim:

1. Naser Osmani - kryetar (LDK)
Tel: 044/501-777
Email: Naser.Osmani@assembly-kosova.org
naser_osmani@hotmail.com
2. Safete Hadergjonaj - zëvendëskryetare e parë (PDK)
Tel: 044/126-145
Email: Safete.Hadergjonaj@assembly-kosova.org
shadergjonaj@hotmail.com
3. Jelena Bontić - zëvendëskryetare e dytë (LS)
Tel: 045 297 937
Email: Jelena.Bontic@assembly-kosova.org
jelenabontic@yahoo.com
4. Adem Grabovci – anëtar (PDK)
Tel: 045 901 111
Email: Adem.Grabovci@assembly-kosova.org

5. Labinote Demi-Murtezi – anëtare (PDK)
Tel: 044 321 954
Email: Labinote.Demi@assembly-kosova.org
labinotedemi.murtezi@hotmail.com
6. Besa Gaxherri – anëtare (LDK)
Tel: 044 600 355
Email: Besa.Gaxherri@assembly-kosova.org
besa.gaxherri@hotmail.com
7. Bardhyl Meta - anëtar (LDK)
Tel: 045 554 466
Email: Bardhyl.Meta@assembly-kosova.org
bardhyl.meta@riinvest.net
8. Ilir Deda – anëtar (VV)
Tel: 044 899-166
Email: Ilir.Dedai@assembly-kosova.org
Ilir.deda@gmail.com
9. Bali Muharremi – anëtare (AAK)
Tel: 044 501 168
Email: Bali.Muharremi@assembly-kosova.org
bali.muharremaj@hotmail.com
10. Enver Hoti– anëtar (NISMA për Kosovën)
Tel: 044 156 113
Email: Enver.I.Hoti@assembly-kosova.org
en_hoti@hotmail.com
11. Fikrim Damka – anëtar (G 6 +)
Tel: 044 113 130
Email: Fikrim.Damka@assembly-kosova.org
fikrimd@hotmail.com

Komisioni ka stafin mbështetës, të përbërë prej 4 anëtarëve, si në vijim:

1. Vilson Ukaj, Kordinator
Tel: 038/ 213-800 ext. 10-626; 044 370 358
Email: Vilson.Ukaj@assembly-kosova.org
2. Sabrije Saliuki-Iseini, Zyrtare e lartë e fushës/analiste
Tel: 038 213 662 ext. 10-641; 049 393 415
Email: Sabrije.Saliuki@assembly-kosova.org
3. Luljetë Krasniqi, Zyrtare e fushës
Tel: 038 200 ext. 10-625; 044 398 939
Email: Luljete.O.Krasniqi@assembly-kosova.org
4. Dashurije Canolli, Nëpunëse administrative
Tel: 038 211 853 ext. 10-648; 044 372 915
Email: Dashurije.Canolli@assembly-kosova.org

III. Objektivat e punës së Komisionit

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në kuadër të fushëveprimtarisë dhe kompetencave, të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, në planin vjetor të punës për vitin 2016, përcakton qëllimet për arritjen e objektivave, si në vijim:

- Angazhimi dhe roli aktiv i komisioni në shqyrtimin/hartimin e rregullativës ligjore nga fushëveprimtaria e kompetencave të komisionit;
- Organizimi i dëgjimeve publike, seancave dëgjimore dhe formave tjera të bashkëpunimit, në procesin e shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve;
- Ngritja e cilësisë së punës dhe bashkëpunimit të brendshëm dhe formimi i grupeve të punës, në rastet kur paraqitet nevoja, për ngritjen e efikasitetit dhe të profesionalizmit në punë;
- Përfshirja aktive e komisionit në procesin e planifikimit buxhetor, përmes diskutimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve dhe shqyrtimit të projektbuxhetit vjetor;
- Mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, realizimi i vizitave në terren, takimi me përfaqësuesit kompetent dhe përgatitja e raporteve që janë objekt diskutimi dhe miratimi në Kuvend;

- Organizimi e takimeve në baza tre mujore me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës, për të diskutuar për nivelin e realizimit të planit të të hyrave buxhetore;
- Mbikëqyrja dhe raportimi i realizimit të hyrave dhe të shpenzimeve të Buxhetit të Republikës së Kosovës, përmes shqyrtimit të raporteve financiare të Qeverisë për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- Monitorimi i zbatimit të rregullës fiskale, që ka të bëjë me nivelin e ruajtjes së deficitit buxhetor dhe të borxhit publik;
- Shqyrtimi i raportit detaj të investimeve kapitale të fondit të rregullës fiskale.
- Shfrytëzimi i ekspertizës së jashtme dhe hulumtimeve legislative;
- Bashkëpunimi i rregullt me Ministrinë e resorit përkatës, institucionet dhe agjencitë e pavarur dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, për arritjen e rezultateve në kryerjen e detyrave ligjore;
- Bashkëpunimi i komisionit me odat ekonomike, shoqatat dhe asociacionet e biznesit, institutet e specializuara në fushën e ekonomisë dhe financave, organizatat e shoqërisë civile, dëgjimi dhe përgjigja e kërkesave të qytetarëve dhe komunikimi me media;
- Zhvillimi i marrëdhënieve të veçanta të bashkëpunimit me Organizatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ, në kuadër të Projektit “Reforma në Sistemin e Financave Publike në Kosovë”;
- Bashkëpunimi i rregullt me të gjitha organizatat relevante ndërkombëtare, që janë të pranishme në Kosovë, siç janë: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore, Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, OSCE, Zyrat e USAID-it, NDI, Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, UNDP dhe organizata tjera.

IV. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të komisionit

Rregullat për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Komisionit, janë të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Në mungesë të rregullave specifike për procedurat në komisionet, rregullat për procedurat e mbledhjes plenare, zbatohen në mënyrë analoge edhe në punën e komisionit. Komisioni ka Kryetarin dhe dy zëvendës-kryetar.

▪ Kryetari:

- Thërret mbledhjet e komisionit, drejton dhe koordinon punën e gjithmbarshme të Komisionit, në bashkëpunim me zëvendës-kryetarët;
- Përfaqëson Komisionin, vetëm ose së bashku me zëvendës-kryetarët dhe anëtarët e komisionit, varësisht nga natyra e përfaqësimit;
- Raporton para Kuvendit për punën e Komisionit dhe paraqet qëndrimet e Komisionit;
- Për çështje të caktuara mund ta autorizojë zëvendës-kryetarët ose anëtarët raportues që të paraqesin qëndrimet e Komisionit.

▪ **Zëvendëskryetarët:**

- Ndhimjnë kryetarin e Komisionit dhe e zëvendësojnë atë, kur ai mungon.

▪ **Raportuesit:**

- Anëtarët e komisionit mund të angazhohen për të raportuar për një çështje të caktuar, apo për të mbuluar dhe hulumtuar një fushë të caktuar dhe për t'i raportuar lidhur me të Komisionit;
- Me pëlqim të Komisionit dhe Kryetarit të tij, raportuesi mund t'i paraqesë qëndrimet e Komisionit edhe para Kuvendit.

▪ **Njësia mbështetëse e komisionit:**

Komisioni ka stafin e tij mbështetës që funksion si Njësi dhe është pjesë e shërbimit civil të administratës së Kuvendit. Njësia ofron mbështetje profesionale dhe teknike për komisionin.

V. Fushëveprimtaria

Komisioni për Buxhet e Financa është komision i përhershëm. Kompetencat e Komisionit për Buxhet dhe Financa, janë paraparë në shtojcën nr. 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komisioni, në kuadër të fushëveprimit shqyrton:

- Çështjet buxhetore dhe ato financiare;
- Implikimet buxhetore për vitin e parë dhe për vitet në vazhdim që e shoqërojnë projektligjin dhe bëjnë rekomandime në komisionin përkatës funksional ose në Kuvend;
- Shqyrton raportet periodike të Ministrisë së Financave, për shpenzimet e institucioneve të Kosovës dhe të organizatave buxhetore që i raportojnë Kuvendit;
- Raporton kohë pas kohe, më iniciativën e vet ose me kërkesën e Kuvendit, në mbledhje plenare për çështjet nga fushëveprimi i tij;
- Angazhohet për shqyrtimin e programit të Qeverisë, mënyrën dhe nivelin e zbatimit të tij në fushën e financave dhe i jep rekomandime Kuvendit;
- Mbikëqyrë zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me financat publike;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe me Qeverinë, që është e detyruar t'i ofrojë të gjitha të dhënat e kërkuara nga ana e Komisionit, përfshirë edhe raportimet e ministrit dhe të personave të tjerë të autorizuar të ministrisë;
- Shqyrton legjislacionin në fushat që lidhen me lëmin e buxhetit dhe të financave;

- Të drejtën për të iniciuar dhe hartuar projektligje;
- Shqyrton projektligjet dhe mocionet, përmbajtjesore lidhur me koston buxhetore, si dhe për veprimtarinë e përgjithshme në Kuvend dhe në institucionet e tjera të Kosovës, që lidhen me fushëveprimin e tij;
- Komisioni ushtron edhe veprimtari të tjera, të cilat përcaktohen me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Shqyrton e çështje të tjera të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe çështjet, të cilat me vendim të veçantë të Kuvendit i barten këtij Komisioni.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me ministrinë e resorit përkatës dhe me të gjitha ministrinë e tjera, nga të cilat mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohej nga Komisioni.

VI. Programi i punës së Komisionit në formë tabelare për vitin 2016

Muaji	Agjenda e Komisionit	Detyrat e Komisionit
Janar	<p>Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksat vjetore për vitin 2016</p> <p>Shqyrtimi i Programin të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-mars 2016</p> <p>Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015</p>	<p>Komisioni, shqyrton kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksat vjetore për vitin 2016, dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.</p> <p>Komisioni shqyrton Programin e Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën janar-mars 2016 dhe harton raportin me rekomandime për Ministrinë e Financave.</p> <p>Komisioni miraton Raportin vjetor të punës së Komisionit vitin 2015.</p>
Shkurt	Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit	Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kuvend.

	<p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të propozuar nga nisma qytetare</p> <p>Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit</p>	<p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin dhe harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Grupi punues vazhdon punën për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit.</p>
Mars	<p>Miratimi i Planit Vjetor të Komisionit për vitin 2016</p> <p>Shqyrtimi i Raportit vjetor për shpenzimet e Kuvendit të Kosovës për vitin 2015</p> <p>Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015</p> <p>Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës</p>	<p>Komisioni, harton dhe miraton planin ku përcaktohen aktivitetet dhe detyrat gjatë vitit 2016.</p> <p>Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kryesinë e Kuvendit.</p> <p>Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend., Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p>

	Shqyrtimi i Raportin e shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016 dhe Programin e Shpenzimeve të RTK-së për periudhën prill - qershor 2016	Komisioni shqyrton Raportin e shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016 dhe Programin e Shpenzimeve të RTK-së për periudhën prill - qershor 2016 dhe harton raportin me rekomandime për Ministrinë e Financave.
Prill	Shqyrtimi i Raportit financiar të Qeverisë së Kosovës për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015	Komision shqyrton Raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.
	Takim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës	Diskutim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës lidhur me procesin dhe realizimin e planit të të hyrave buxhetore, në tremujorin e parë të vitit 2016.
	Monitorim i zbatimit të rregullës fiskale – Raportim nga Ministri i Financave	Ministri e Financave, raporton lidhur me zbatimin e rregullës fiskale (respektimi i nivelit të kufirit të deficitit buxhetor dhe nivelit e borxhit publik, përfshirë financimin e projekteve kapitale përmes huamarrjeve të jashtme).
	Shqyrtimi në parim i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme	Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.
	Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim	Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.
	Shqyrtimi i raporteve vjetore të punës dhe financiare të institucioneve të pavarura për vitin 2015, të cilat i raportojnë Kuvendit	Komisioni shqyrton raportet vjetore të punës dhe financiare të institucioneve dhe agjencive të pavarura, dhe harton raportet me rekomandime për Kuvend.
	Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme	Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.
	Informacione dhe takimet të Raportuesve me Organizatat Buxhetore, që i paraprijnë KASH-it 2017-2019	Raportuesit kërkojnë informata dhe takime me Organizatat Buxhetore në lidhje me KASH-in 2017-2019

	<p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale</p> <p>Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, për tremujorin e parë të vitit 2016</p> <p>Raporti financiar i Qeverisë së Kosovës për Buxhetin e Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016</p> <p>Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për Kuvendin e Kosovës për vitin 2017-2019</p>	<p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Seancë Plenare, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p> <p>Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kryesinë e Kuvendit.</p> <p>Diskutim i Raportit tremujor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Raportuesit do të raportojnë për sektorët e tyre para Komisionit për Buxhet dhe Financa (KBF).</p> <p>Komisioni e shqyrton KASH-in e Kuvendit të Kosovës për vitin 2017-2019 dhe harton raportin me rekomandime për Kryesinë e Kuvendit.</p>
Maj	<p>Korniza Afatmesme e Shpenzimeve për vitin 2017-2019</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale</p> <p>Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës</p> <p>Hartimi i Projektligjit për Lojërat e Fatit</p>	<p>Komisioni diskuton Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2017-2019. Prezantimi i Raportuesve për sektorët e caktuar.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-021 për akcizën në produktet e duhanit, harton raportin me rekomandime për miratim në Komision. Komisioni miraton raportin e grupit punues dhe e procedon për shqyrtim dhe miratim në Seancë plenare.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Komisioni harton Projektligjin për Lojërat e Fatit dhe të njëjtin e propozon</p>

		për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.
Qershor	Shqyrtimi i Raporti vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015	Komisioni harton raportin me rekomandime për Kuvend.
	Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Agjencinë e të hyrave	Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.
	Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/-196 dhe Ligjit Nr.04/L-048 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit	Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.
	Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit	Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.
	Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale	Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.
	Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e të hyrave	Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.
	Hartimi i Projektligjit për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare	Komisioni harton Projektligjin për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe të njëjtin e propozon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.
	Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/-196 dhe Ligjit Nr.04/L-048 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit	Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.
	Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe	Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton

	<p>ndryshimin e Ligjit Nr. 04/-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit</p> <p>Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-014 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim</p> <p>Rishqyrtimi i planit të punës së Komisionit për gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2016</p>	<p>grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Komisioni cakton grupin punues i cili harton planin e veprimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat. Komisioni do të angazhoj ekspert vendor që do të ndihmojnë grupin punues në aktivitetin mbikëqyrës.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Rishikimi i realizimit të planit të punës dhe plotësimi apo ndryshimi eventual i tij, për gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2016.</p>
Korrik	<p>Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Fondet investive</p> <p>Raporti financiar i Qeverisë së Kosovës për Buxhetin e Republikës së Kosovës për gjashtëmuor e parë të vitit 2016</p>	<p>Komisioni harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni diskuton raportin financiar gjashtëmuor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Raportuesit do të raportojnë për sektorët e tyre para KBF-së.</p>

	<p>Takim i përbashkët i Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) për të diskutuar rekomandimet e KMFP, të cilat mund të inkorporohen në rishikimin buxhetor.</p> <p>Takim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës</p> <p>Monitorim i zbatimit të rregullës fiskale – Raportim nga Ministri i Financave</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Fondet investive</p> <p>Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale.</p>	<p>Prezantimi i rekomandimeve nga KMFP tek KBF të cilat rekomandime do t'i ndihmojnë KBF që të marrë masat e nevojshme për përmirësim të shpenzimeve publike me rastin e rishikimit buxhetor.</p> <p>Diskutim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës lidhur me procesin dhe realizimin e planit të të hyrave buxhetore, në tremujorin e dytë të vitit 2016.</p> <p>Ministri e Financave, raporton lidhur me zbatimin e rregullës fiskale (respektimi i nivelit të kufirit të deficitit buxhetor dhe nivelit e borxhit publik, përfshirë financimin e projekteve kapitale përmes huamarrjeve të jashtme).</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kryesinë e Kuvendit.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p>
Gusht	Pushimet verore	
Shtator	Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale	Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.

	<p>Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e të hyrave</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/-196 dhe Ligjit Nr.04/L-048 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit</p> <p>Vizita studimore në Gjermani së bashku me Komisionin për Mbikqyrjen e Financave Publike.</p>	<p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Kuptimi dhe adoptimi i praktikave gjermane sa i përket rezultateve të cilat rrjedhin si rrjedhojë e një bashkëpunimi në mes të këtyre dy komisioneve dhe të cilat kontribuojnë në krijimin e një kulturë efikase në mbikqyrjen e parasë publike.</p>
Tetor	<p>Takim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës</p> <p>Monitorim i zbatimit të rregullës fiskale – Raportim nga Ministri i Financave</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore</p>	<p>Diskutim me Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganat e Kosovës lidhur me procesin dhe realizimin e planit të të hyrave në tremujorin e tretë të vitit 2016.</p> <p>Ministri e Financave, raporton lidhur me zbatimin e rregullës fiskale (respektimi i nivelit të kufirit të deficitit buxhetor dhe nivelit e borxhit publik, përfshirë financimin e projekteve kapitale përmes huamarrjeve të jashtme).</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p>

	<p>Shqyrtimi i Projektligjit për Fondet investive</p> <p>Raporti financiar i Qeverisë së Kosovës për Buxhetin e Republikës së Kosovës për nëntëmujor e vitit 2016</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal</p> <p>Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitin 2016</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksional</p> <p>Takim i përbashkët me Komisionin për Mbikqyrjen e Financave Publike - njoftim me rekomandimet e KMFP të nxjerra nga raporti vjetor i auditorit të përgjithshëm.</p> <p>Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat</p>	<p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme të Kuvendit.</p> <p>Komisioni diskuton raportin financiar nëntëmujor për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016. Raportuesit do të raportojnë për sektorët e tyre para KBF-së.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Komisioni harton Raportin me rekomandime për Kryesinë e Kuvendit.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p> <p>Prezantimi i rekomandimeve të raporti vjetor të auditimit nga KMFP tek KBF të cilat rekomandime do t'i ndihmojnë KBF që të merre masat e nevojshme për përmirësim të shpenzimeve publike me rastin e shqyrtimit të Draft Buxhetit.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, dhe harton raportin me rekomandime për miratim në Komision. Komisioni miraton raportin e grupit punues dhe e procedon për shqyrtim dhe miratim në Seancë plenare.</p>
Nëntor	<p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale</p>	<p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvendin.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale, lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p>

	<p>Takim i përbashkët i Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe KMFP për të diskutuar rekomandimet e KMFP të cilat mund të inkorporohen në buxhet – Takimet individuale të Raportuesve</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-170 për Masat Doganore për mbrojtjen e të Drejtave Pronësore Intelektuale</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-170 për Masat Doganore për mbrojtjen e të Drejtave Pronësore Intelektuale</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave</p>	<p>Prezantimi i rekomandimeve nga KMFP tek KBF, të cilat rekomandime do t'i ndihmojnë KBF që të merre masat e nevojshme për përmirësim të shpenzimeve publike me rastin e rishikimit buxhetor. Takimet individuale të Raportuesve për sektorë të caktuar.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni në pajtim me Rregulloren e Punës miraton planin e veprimit për shqyrtimin e projektbuxhetit të vitit 2017 dhe harton orarin e takimeve të Raportuesve dhe mbledhjeve të KBF për shqyrtimin e buxhetit. Raportuesit për punën e tyre përgatisin informacione mbi procesin e dëgjimeve buxhetore dhe hartojnë raportet me rekomandime, për miratim në Komision.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p>
Dhjetor	<p>Shqyrtimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal</p>	<p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme në Kuvend.</p>

	<p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës</p> <p>Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare</p> <p>Shqyrtimi i projektligjeve me raportet e komisioneve funksionale</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-170 për Masat Doganore për mbrojtjen e të Drejtave Pronësore Intelektuale</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave</p> <p>Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Doganës dhe Administratës Tatimore të Kosovës</p>	<p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Komisioni shqyrton Projektligjin në parim dhe harton raportin me rekomandime për Kuvend.</p> <p>Shqyrtimi i të gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale lidhur me përmbajtjen e implikimeve buxhetore.</p> <p>Pas miratimit të Projektligjit në lexim të parë në Kuvend, Komisioni cakton grupin punues për shqyrtimin e projektligjit dhe raportimin në komision.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme në Kuvend.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme në Kuvend.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme në Kuvend.</p> <p>Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme në Kuvend.</p>
--	---	---

	Shqyrtimi i Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-093 për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare	Grupi punues përfundon punën në shqyrtimin e projektligjit dhe raportin me rekomandime e procedon për miratim në Komision. Komisioni harton raportin me amendamente dhe të njëjtin e procedon për shqyrtim dhe miratim në procedura të mëtutjeshme në Kuvend
	Shqyrtimi i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017	Komisioni përfundon shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017 dhe harton raportin final me rekomandime Raportit, për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.Me rastin e amendamentimit të Projektligjit të Buxhetit, duhet ekzistuar dispozita të qarta për përfshirjen e Kuvendit, në rastet e kërkesave për rialokime administrative dhe ndryshimin e ligjit vjetor të buxhetit, që paraqiten gjatë vitit të zbatimit të buxhetit.

Plan-programi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është hartuar në harmoni me Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2017 dhe aktivitetet e përbashkëta të planifikuara me Organizatën Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ) “Projekti për Reformën e Sistemit të Financave Publike në Kosovë”.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Prishtinë, 07.03.2016

**Kryetari i Komisionit,
Naser OSMANI**